



---

**VENDIM**

**Nr. 29 Datë 02.04.2010**

**MBI**

**KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE  
NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME  
SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SH.A (FURNIZUESIT PUBLIK  
ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2010 DERI MË 31.12.2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, 9, dhe 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 gërma ”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, i ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 date 23.06.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 02.04.2010, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike të ERE, mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2010 deri më 31.12.2010“,

**Konstatohet se :**

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe OSSH /FPP, janë të licensuara nga ERE përkatësisht:
  - “OSSH” sh.a është licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.9 datë 25.01.2008, i ndryshuar,
  - “KESH” sh.a është licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 11 datë 23.06.2006, i ndryshuar.
- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a (FPSH) dhe OSSH sh.a (FPP) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.
- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.
- Në kontratën tip të miratuar nga ERE me vendimin të ERE nr.72 datë 24.06.2008 “Për miratimin e kontratës tip për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH dhe FPP”, në pikën 15 përcaktohet se dokumentat

mbështetës të kredise mund të kërkohen në cdo kohë si në datën e hyrjes në fuqi të kontratës ose në cdo kohë më pas, si të tillë nuk është kusht i domosdoshëm për tu kërkuar dhe përcaktuar termat e saj para apo në momentimin e miratimit nga Bordi.

- Kontrata e furnizimit me energji elektrike ndërmjet KESH sh.a/ Furnizuesi Publik me Shumicë dhe OSSH sh.a /Furnizuesi Publik me Pakicë për periudhën 01.01.2009 deri më 31.12.2009 e miratuar me vendimin nr.55 date 03.08.2009”, nuk përbën një vullnet të mirëfilltë të palëve duke ditur që aksioneri që zotëron paketën kontrolluese të njerës prej palëve është ndryshuar në kuadër te privatizimit të OSSH sh.a.

Për sa më sipër evidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. KESH sh.a dhe OSSH sh.a deri në nënshkrimin e një kontrate midis tyre, për furnizimin me energji elektrike për vitin 2010, për marrëdhënien e furnizimit me energji elektrike të zbatojnë kontratën tip të furnizimit me energji elektrike të miratuar nga ERE me vendimin nr.72, datë 24.06.2008 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike ndërmjet KESH sh.a / Furnizuesi Publik me Shumicë dhe OSSH sh.a /Furnizuesi Publik me Pakicë , të ndryshuar në nenin 8, pika 1, sipas vendimit nr.55, date 03.08.2009.
2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a/FPPSH tek OSSH sh.a/FPP është sipas vendimit nr.95, datë 15.12.2009 “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe mbrojtës se Konsumtorit te njoftojë palët për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2010.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**